

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7851
E premte, 2 gusht 2024
Çmimi 0.50

Reagim i KMDLNj-së
**Lojë e pandershme
e Gjykatës Speciale
Raciste!** | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

HARADINAJ: OSMANI TË DISTANCOHET NGA QEVERIA KURTI

 | FAQE 4

Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë (AAK), Ramush Haradinaj, ka kërkuar të enjten nga presidentja e vendit, Vjosa Osmani, të distancohet nga qeveria Kurti. "Presidentja ka kërkuar votë për këtë opsion

qeverisë. Ka kërkuar votë për një perspektivë euroatlantike dhe integritet. Ka kërkuar votë edhe për çkapjen e shtetit e po del që ka ndodhur e kundërta. Ajo ka qenë bartëse e listës së LV-së dhe në atë

kohë ka kërkuar votë për zhvillim ekonomik dhe po shihet se ka ndodhur e kundërta. Prandaj, mendoj se i takon presidentes të distancohet në tërësi nga qeveria Kurti", ka thënë Haradinaj

**KRYETARI
KASTRATI
UA DHA ÇMIMIN
"QYTETAR NDERI"
I MALISHEVËS
PERSONALITETEVE
AMERIKANE DAVID
CARR, CHARLES
D. FALL DHE
NASER NIKA** | F. 5



**QEVERIA REALIZOI
VETËM 33 % TË
PLANIT KOMBËTAR
PËR ZHVILLIM
PËR PERIUdhËN
JANAR - QERSHOR
2024** | F. 7



AKTUALE




**MOTI I NXEHTË SHTYN HAPJEN E
QENDRËS PËR EMIGRANTË NË
GJADËR** | F. 2

**MBAHET MBLEDHJA E KËSHILLIT TË
SIGURISË SË KOSOVËS, DISKUTOHET
PËR SIGURINË NË VEND** | F. 7

**LV-ja PYET OSMANIN: MBI ÇFARË
BAZE KUSHTETUESE E LIGJORE
REFUZON KRYEPARLAMENTARIN NË
TAKIM?** | F. 3

EKONOMI



**MBI NJË MILIARD EURO
TË MBLEDHURA NGA DOGANA** | F. 8

**QEVERIA I KËRKON MENAXHMENTIT
TË TREPÇËS T'I ULË SHPENZIMET
DHE TA RËRISË PRODHIMIN** | F. 8

SPORT



**LORIANA KUKA PENSIONOHET
PAS ELIMINIMIT NGA LOJËRAT
OLIMPIKE** | F. 10

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Moti i nxehtë shtyn hapjen e qendrës për emigrantë në Gjadër

GJADËR, 1 GUSHT - Më 1 gusht pritej që në Gjadër të Shqipërisë të hapej qendra për pritjen e strehimit të migrantëve që shpëtohen në det, por kjo qendër nuk pritet të jetë funksionale edhe për disa javë.

Në qendrën tjetër, atë në Shëngjin, punimet kanë përfunduar, por në Gjadër punimet po vazhdojnë dhe nuk dihet se kur mund të jetë funksionale. Të dy qendrat është paraparë të hapen njëkohësisht. Kryeministrja italiane Giorgia Meloni gjatë vizitës së saj në qendrën e pritjes së migrantëve në Shëngjin gjatë muajit qershor deklaroi se qendrat për pritjen e emigrantëve do të hapeshin më 1 gusht.

Ngritja e dy qendrave është pjesë e marrëveshjes që u firmos mes Italisë dhe Shqipërisë në nëntor të vitit të kaluar si një përpjekje për ta frenuar migracionin.

Ambasadori i Italisë në Tiranë, Fabrizio Bucci, ishte gjatë ditës së hënë në dy qendrat për emigrantët. Ai shpjegoi për gazetarët se shkak për këtë vonesë kanë qenë temperaturat e larta.

Ambasadori theksoi se brenda pak javësh edhe kjo qendër do të jetë funksionale, por tha se nuk mund të jepte një datë të saktë. “Vala e të nxehtëit në korrik i detyroi autoritetet të vendosin disa orë pushim gjatë orëve më të nxehta të ditës. Shqetësimi ynë kryesor mbetet siguria dhe mbrojtja e punëtorëve në kantier dhe sigurisht edhe e emigrantëve që do të strehohen në Gjadër. Është e vështirë të thuash një datë, bëhet fjalë për pak javë”, tha Bucci. Ai shtoi se të dyja qendrat do të funksionojnë paralelisht, ndërsa personeli italian tashmë është gati ta nisë punën. “Qendra në Shëngjin tashmë është krejtësisht gati. Por, të dyja qendrat do të funksionojnë paralelisht. Në Shëngjin do të bëhen procedurat e para, pastaj këtu është akomodimi. Tashmë kanë ardhur nga Italia, policët, karabinierët, Guardia Di Finanza, personeli nga Ministria e Drejtësisë, mjekë dhe infermierë. Bëhet fjalë për qindra persona”, tha ambasadori italian. Gjatë inspeksionit në Gjadër u pa se kontejnerët janë vendosur, ndërsa makineritë e rënda si vinça



apo kamionë janë ende në punë për të përfunduar të gjitha punimet. Në këtë qendër, përveç zonës së akomodimit, ku ishin vendosur shtretërit (dykatësh), ka edhe disa struktura të tjera ku do të organizohen shërbimet për emigrantët. Bëhet fjalë për përgatitjen e ushqimit, për strukturat ku do të ofrohet shërbimi dhe kujdesi shëndetësor, si dhe strukturat e posaçme për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë. Të dyja qendrat do të kenë personel italian dhe do të funksionojnë nën juridiksionin italian. Megjithatë, siguria e

jashtme do të bëhet nga rojet shqiptare. Sipas marrëveshjes, fillimisht pritet të strehohen rreth 3 000 persona, ndërsa në një vit fluksi mund të shkojë deri në 36 000 persona.

Hyrja e emigrantëve në ujërat territoriale dhe në territorin e Shqipërisë do të kryhet ekskluzivisht me mjetet e autoriteteve italiane. “Autoritetet kompetente shqiptare lejojnë hyrjen dhe qëndrimin në territorin shqiptar të emigrantëve të strehuar në strukturat me qëllimin e vetëm të kryerjes së procedurave kufitare apo të

riatdhësimit, të parashikuara nga legjislacioni italian e evropian dhe për kohën rreptësisht të nevojshme për të”, thuhet në protokollin e marrëveshjes, që publikoi Qeveria shqiptare.

Aty nënvizohet se autoritetet italiane do të përballojnë çdo shpenzim të nevojshëm për akomodimin dhe trajtimin e emigrantëve, duke përfshirë ushqimin, kujdesin shëndetësor dhe çdo shërbim tjetër që do të vlerësohet i nevojshëm dhe duke u kujdesur që ky trajtim të respektojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, sipas së drejtës ndërkombëtare.

Italia, sipas marrëveshjes, do të financojë të gjitha shërbimet e kujdesit spitalor, por edhe të pajisjeve, sikurse automjetet dhe karburantet si dhe pagesat për avokatë. Ndërkaq, Shqipëria do të ofrojë lehtësira për personelin italian që do të punojë në Shqipëri, të cilët do të përjashtohen nga nevoja për pajisje me viza, leje të qëndrimit dhe kërkesa të tjera që kërkohen nga legjislacioni shqiptar për migracion.

Avionët e parë luftarakë F-16 mbërrijnë në Ukrainë



KIEV, 1 GUSHT - Tufa e parë me avionët e shumëpritur luftarakë, F-16, ka mbërritur në Ukrainë, thanë ministri i Jashtëm i Lituanisë dhe një zyrtar amerikan të mërkurën.

F16-shat, të ndërtuar nga Lockheed Martin, kanë qenë dëshirë e kamotshme e Ukrainës, për shkak të forcës së tyre shkatërruese. Ky avion mund të bartë bomba, predha dhe raketa. “F16-shat në Ukrainë. Një gjë tjetër e pamundur doli të ishte plotësisht e mundur”, tha ministri i Jashtëm i Lituanisë,

Gabrielius Landsbergis, në rrjetin social X.

Një zyrtar amerikan, duke folur në kushte anonime, tha se dërgimi i avionëve F-16 në Ukrainë është kompletuar.

Danimarka është zotuar se do t’ia dërgojë Ukrainës në përgjithësi 19 avionë luftarakë, ndërsa Holanda ia ka premtuar 24 sosh.

Këto dy vende kanë qenë forcë shtytëse e koalicionit ndërkombëtar për ta furnizuar Ukrainën me avionë F-16.

Edhe Norvegjia ka thënë se do t’ia dhurojë Ukrainës gjashtë avionë

luftarakë F-16.

Pilotët ukrainas janë trajnuar se si t’i përdorin F16-shat nga partnerët perëndimorë për muaj të tërë. Ushtria ukrainase është detyruar të varet nga një tufë e vogël e avionëve luftarakë të epokës sovjetike për ta zmrapsur pushtimin rus, që nisi më 2022.

Zyrtarët ukrainas i shohin avionët F-16 si një përditësim jetik për Forcën e tyre Ajrore. Disa analistë thonë se vetëm avionët F-16 nuk do të dëshmojnë si pikë kthese në luftën pushtuese që Rusia e nisi në shkurt të vitit 2022.

Netanyahu thotë se Izraeli do të përgjigjet “fuqishëm” ndaj çdo sulmi

JERUSALEM, 1 GUSHT - Izraeli do të përgjigjet me forcë ndaj çdo sulmi kundër tij, ka thënë kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu. Kjo ishte deklarata e parë publike e Netanyahu prej vrasjes në Teheran të Ismail Haniyeh, liderit politik të Hamasit - grupit të shpallur terrorist nga ShBA dhe BE. Por, Netanyahu nuk e përmendi vrasjen e tij. Hamas dhe Irani e kanë fajësuar menjëherë Izraelin për vrasjen e Haniyehit, e cila e ka rritur rrezikun për një luftë të përgjithshme rajonale.

Pak orë para vrasjes së liderit palestinez, Izraeli tha se e vrau një komandant të lartë të grupit militant libanez, Hezbollah, në një sulm ajror në kryeqytetin e Libanit, Bejrut. “Qytetarë të Izraelit, na presin ditë sfiduese. Prej sulmit në Bejrut, kërcënimet po vijnë nga të gjitha drejtimet. Ne jemi të përgatitur për çdo skenar dhe do të qëndrojmë të bashkuar dhe të vendosur kundër çdo kërcënimi. Izraeli do të përgjigjet fuqishëm kundër çdo agresionit kundër nesh”, tha Netanyahu në një deklaratë



televizive.

Të martën, ushtria izraelite

njoftoi se e ka vrarë Fuad Shukur, për të cilin tha se ishte

komandanti më i lartë i Hezbollahut, duke e akuzuar atë për një sulm në fundjavë në të cilin u vranë dhjetëra të rinj në Lartësitë e Golanit, të okupuara nga Izraeli. Hezbollahu, i cili mbështetet nga Irani, konfirmoi të mërkurën vdekjen e Shukur, pak orë pasi Hamas njoftoi se lideri i saj politik Haniyeh u vra në Teheran.

Qeveria e Netanyahu nuk e ka marrë përgjegjësinë për vrasjen e liderit të Hamasit dhe ka thënë se nuk e komenton atë.

Reagim i KMDLNj-së

Lojë e pandershme e Gjykatës Speciale Raciste!

Salih Mustafa fillimisht ishte dënuar me 26 vite burgim të rëndë ndërkaq që Gjykata Supreme ia shqiptoi një dënim me 22 vite të rëndë burg. Pas ankimit të këtij vendimi rasti i kthehet përsëri Gjykatës së Apelit e cila do të diskutojë për lartësinë e dënimit. GJSR në Hagë ishte votuar në rrethana terrori nga deputetët e Kuvendit të Kosovës. E vërteta është se disa deputetë kanë votuar me dëshirë sikur që kanë dhënë kontribut të madh për arrestimin e udhëheqësve të lartë politik dhe ushtarak që janë duke u gjykuar apo që tashmë janë dënuar. GJSR gjithmonë është deklaruar se është pjesë e sistemit të drejtësisë së Kosovës dhe se punojnë sipas ligjeve të Kosovës ndonëse kurrë dhe me asgjë nuk e kanë dëshmuar këtë. Përkundrazi, turpërisht kanë injoruar institucionet e Kosovës e në veçanti Policinë e Kosovës dhe Ministrinë e Drejtësisë. Në proceset që kualifikohen si shkelje e rëndë e të Drejtës Humanitare në shtetet që janë

formuar nga shpërbërja e ish Jugosllavisë ndaj të dënuarve është zbatuar ligji më i favorshëm për të akuzuarit, i aplikueshëm në kohën kur ishte kryer vepra e që kështu nuk ishte vepruar në rastin Salih Mustafa dhe Pjetër Shala. Edhe në Kosovë ndaj serbëve të akuzuar për krime lufte është zbatuar kjo e drejtë më e favorshme për të akuzuarit ku lartësia e dënimit nuk i kalon 15 vjet e që në disa raste ka shkaktuar protesta të viktimize dhe qytetarëve të pakënaqur me këtë vendim të gjykatës. Nëse kemi parasysh faktin se për gjenocidin në Srebrenicë ku janë ekzekutuar mbi 8500 boshnjakë nga ushtria serbe janë shqiptuar 4 dënime me burg të përjetshëm ndërsa dënimet me burg efektiv dënimi më i lartë ishte 36 vjet kurse i ulëti ishte 5 vjet, dënimet ndaj shqiptarëve janë drakonike dhe kriminale pasi as në rastin Salih Mustafa apo Pjetër Shala nuk ishte vërtetuar përgjegjësia konkrete për vrasjen e dy personave, njëri nga Salih



Mustafa e tjetri nga Pjetër Shala. Dënimet e kësaj gjykate janë qartazi prapavijë etnike dhe politike e assesi nuk sigurojnë drejtësi për viktimat apo përgjegjësi për ata që e kanë kryer krimin e që deri më tani mbesin të panjohur. Një gjykatë që nuk i nënshtrohet asnjë kontrolli përmes monitorimit të

pavarur dhe që nuk jep asnjë llogari siç është GJSR në Hagë domosdoshmërisht i nënshtrohet ndikimit të politikës apo grupeve të interesit që nënkupton që mungojnë kushtet elementare për një gjykim të drejtë, fer, të paanshëm dhe të pandikueshëm e që garantohet nga Kushtetuta e Kosovës,

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e Kombeve të Bashkuara dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Tash, Salih Mustafës mund t'i ulet ndjeshëm dënimi por se për te e as për drejtësinë nuk paraqet zgjidhje apo sukses, padrejtësia tashmë ka marrë formë juridike. Deputetët e Kuvendit të Kosovës janë treguar të mjerë dhe qyqarë, sidomos këta të Komisioneve për të Drejtat e Njeriut dhe Legjislacion duke e refuzuar mandatin e fituar nga votuesi për përfaqësim dhe mbrojtje të interesit të qytetarëve pavarësisht përkatësisë etnike, bindjeve fetare dhe politike si dhe statusit në shoqëri. Ministria e Drejtësisë e ka përmbushur qëllimin e mandatit që ia caktuar vetes duke dobësuar mbrojtjen efektive juridike të të akuzuarve, të gjithë shtetas të Kosovës dhe të gjithë shqiptarë duke ua shkurtuar mjetet financiare larg syve të publikut, pa transparencë, pa debat dhe në mënyrë të kundërligjshme.

LV-ja pyet Osmanin: Mbi çfarë baze kushtetuese e ligjore refuzon kryeparlamentarin në takim?

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 1 GUSHT - Të mërkurën presidentja e vendit, Vjosa Osmani, priti në një takim liderët e partive politike për të diskutuar rreth datës së zgjedhjeve nacionale në vend, në të cilin takim nuk morën pjesë disa krerë të partive politike, e një ndër ta edhe ai i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti.

E nga kjo parti deklaruan se në mungesë të Kurtit në këtë takim do të marrë pjesë nënkryetari i partisë, Glauk Konjufca, i cili u refuzua nga Osmani pasi, siç deklaroi ajo, "ky takim



konsultativ është vetëm për nivel të kryetarëve, këtë parim e kemi mbajtur për të gjithë". Me këtë deklaratë të Osmanit nuk janë pajtuar nga LV-ja. Kjo parti ka kërkuar nga presidentja

të tregojë se mbi çfarë baze kushtetuese e ligjore refuzoi zëvendësimin e kryetarit të subjektit politik. "Kryeministri Kurti nuk mund të jetë në dy vende njëkohësisht, andaj ai

është dashur të peshojë: ta anulojë pjesëmarrjen e konfirmuar qysh para tri javësh në drekë me 21 ambasadorë, apo të shkojë aty dhe në vend të tij me partitë politike te presidentja Osmani të shkojë nënkryetari i parë dhe kryeparlamentari Konjufca. Me të drejtë e ka përzgjedhur të dytën. Pyetja që duhet shtuar është: mbi çfarë baze kushtetuese e ligjore presidentja refuzon zëvendësimin e kryetarit të subjektit politik (që është edhe kryeministër) me nënkryetarin e parë (që është edhe kryeparlamentar)?", ka shkruar në "Facebook" deputeti i LV-së, Adnan Rrustemi.

E pyetur për mospjesëmarrjen e kreut të Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, në takimin konsultativ, presidentja Osmani tha se nuk i di arsyet. "Të gjitha partitë kanë qenë të ftuara në nivel kryetarësh dhe nënkryetari i LV-së, Glauk Konjufca, shprehu gatishmëri të vijë sot në takim. Mirëpo, meqë krejt partitë ishin të njoftuara se ky takim konsultativ është vetëm për nivel kryetarësh, këtë parim e kemi mbajtur për të gjithë dhe ai e zbatoi me mirëkuptim. Kryetari i LV-së nuk ka qenë në takim. Ne nuk i dimë arsyet. Mund ta pyesni atë drejtpërdrejt. Mund të shkoni në zyrën e tij dhe ta pyesni", u shpreh Osmani.

Haradinaj: Po më shqetëson situata e rëndë e pjesëtarëve të kategorive të lirisë

PRISHTINË, 1 GUSHT - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka mbajtur një tryezë me përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta, në të cilën është folur për një situatë alarmante ndaj kësaj kategorie. Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se është i shqetësuar tej mase me situatën e rënduar të pjesëtarëve të kategorive të

lirisë. "Të dhënat që u prezantuan nga përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta, në një tryezë të organizuar nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, flasin për një situatë alarmante. Veteranët me paga qesharake, invalidët pa asistencën e nevojshme shëndetësore, familjet e dëshmorëve në harresë totale. Kjo shoqëri duhet që

urgjentisht ta rikthejë dinjitetin e kategorive të lirisë, pjesëtarët e të cilave janë më meritoret për lirinë që e gëzojmë sot. Aleanca do të jetë e vendosur ta rikthejë dinjitetin e luftëtarit, të veteranit, të invalidit dhe të familjeve të dëshmorëve të lirisë. Ata që e harrojnë të shkuarën, rrezikojnë që ajo t'u përsëritet", ka thënë Haradinaj.





Haradinaj: Osmani të distancohet nga qeveria Kurti

Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë (AAK), Ramush Haradinaj, ka kërkuar të enjten nga presidentja e vendit, Vjosa Osmani, të distancohet nga qeveria Kurti. “Presidentja ka kërkuar votë për këtë opsion qeverisës. Ka kërkuar votë për një perspektivë euroatlantike dhe integritet. Ka kërkuar votë edhe për çkapjen e shtetit e po del që ka ndodhur e kundërta. Ajo ka qenë bartëse e listës së LV-së dhe në atë kohë ka kërkuar votë për zhvillim ekonomik dhe po shihet se ka ndodhur e kundërta. Prandaj, mendoj se i takon presidentes të distancohet në tërësi nga qeveria Kurti”, ka thënë Haradinaj

EPOKA ERE**Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 1 GUSHT - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë (AAK), Ramush Haradinaj, ka kërkuar të enjten nga presidentja Vjosa Osmani të distancohet nga qeveria Kurti, teksa shprehi

skepticizëm për mundësitë e mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshme. Sipas tij, ekzekutivi ka një mori dështimesh si në ekonomi, politikë të jashtme, por edhe dëmtim të raporteve me aleatët. “Presidentja ka kërkuar votë për këtë opsion qeverisës. Ka kërkuar

votë për një perspektivë euroatlantike dhe integritet. Ka kërkuar votë edhe për çkapjen e shtetit e po del që ka ndodhur e kundërta. Ajo ka qenë bartëse e listës së LV-së dhe në atë kohë ka kërkuar votë për zhvillim ekonomik dhe po shihet se ka ndodhur e kundërta. Prandaj, mendoj se i takon presidentes të distancohet në tërësi nga qeveria Kurti dhe nga ky koncept humbës qeverisës”, ka thënë Haradinaj në një konferencë për medie mbajtur në selinë e AAK-së.

Ai ka thënë se është koha e duhur që Osmani t’u kërkon falje qytetarëve të vendit që në ato që ka besuar dikur nuk kanë ndodhur me këtë qeveri.

Haradinaj ka thënë se Kurti përmes dorëheqjes do ta lironte Kosovën nga një agjendë e dyshimtë.

Haradinaj i është përgjigjur deputetit të Vetëvendosjes, Mefail Bajqinovci, në lidhje me

deklaratat për kriminelin serb Milan Radojiçiq. Ai ka thënë se Bajqinovci dhe deputetët e tjerë të LV-së fjalimet i kanë të shkruara nga zyrtarja e njohur e tyre Dejana Mihali. “Te Bajqinovci e deputetët e tjerë, këto i kanë të shkruara prej Dejonës. Çka me thënë... nuk flasim prej mendjes, pa e marrë porosinë, heshtin. Mendoj se Kurti veprimin më të mirë përpos dorëheqjes, të paktën kishte mundur ta lironjë Kosovën nga një agjendë e dyshimtë, pra nga kjo zonja Mihali, Bajqinovci e Bajqinovcat e tjerë. Po u them se në qeverisjen time është realizuar statuti i ‘Trepçës’, ushtria dhe pavarësimi energjetik”, ka thënë Haradinaj.

Lideri i AAK-së ka numëruar tri arsye pse kjo parti e ka propozuar 26 janarin datë të zgjedhjeve në takimin e partive politike me presidenten Osmani. Sipas tij, vendi duhet të shkojë në zgjedhje sa më shpejt për shkak të dështimeve të njëpasnjëshme të

qeverisë të cilat ai i ka ndarë në tri grupe: dështimet në marrëdhëniet ndërkombëtare, ato ekonomike dhe kapja e institucioneve të vendit. “Ju kam ftuar këtu për tri grupe të dështimeve të qeverisë së vendit, të cilat janë edhe arsyet pse AAK-ja e ka propozuar 26 janarin datë të zgjedhjeve. Së pari, dështimet në marrëdhëniet e jashtme, me aleatët më të rëndësishëm të Kosovës, BE dhe ShBA. Grupi i dytë i dështimeve është në kapjen e institucioneve të pavarura. Nuk ka mbetur asnjë institucion që nuk i është armiqësuar kjo qeveri. Grupi i tretë ka të bëjë me dështimet ekonomike, mosinvestimi dhe mosrritja e pagave e deri te paaftësia për ta ndaluar rritjen enorme të çmimeve. Këto janë arsyt kryesore edhe pse në takimin e djeshëm e propozuam 26 janarin datë të zgjedhjeve, në mënyrë që Kosovës t’ia shkurtojmë për disa javë këtë gjendje dëshpëruese”, ka thënë Haradinaj.

Kuvendi gjatë sesionit pranveror mbajti 22 seanca

PRISHTINË, 1 GUSHT - Kuvendi i Republikës së Kosovës gjatë sesionit pranveror ka vazhduar punën e tij konform funksioneve kushtetuese, duke miratuar ligje, rezoluta, deklarata, rekomandime si dhe duke trajtuar çështje e problematika me interes qytetar. Kështu gjatë këtij sesioni pranveror Kuvendi ka mbajtur gjithsej 22 seanca,

gjatë të cilave ka miratuar 36 ligje, përfshirë këtu marrëveshjet ndërkombëtare. Po ashtu, Kuvendi ka miratuar shtatë deklarata, gjashtë rekomandime, një rezolutë dhe një statut. Sipas rolit të tij mbikëqyrës, Kuvendi ka adresuar 110 pyetje për anëtarë të kabinetit qeveritar. Janë mbajtur 12 mbledhje të kryesisë, në të cilat

janë marrë 138 vendime, janë nxjerrë 17 përfundime dhe janë miratuar tri rregullore të brendshme.

Komisionet parlamentare kanë mbajtur gjithsej 185 mbledhje, duke i propozuar seancës për shqyrtim 43 projektligje dhe 736 amendamente.

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar 15 raporte të institucioneve të pavarura.



KQZ-ja: Votimi me kusht nuk do të lejohet në çdo qendër votimi si në të kaluarën, por vetëm në disa prej tyre

PRISHTINË, 1 GUSHT - Ligji ri për Zgjedhjet e Përgjithshme, i miratuar në vitin 2023, ka bërë disa ndryshime thelbësore edhe për procesin e votimit me kusht. Ky lloj votimi, sipas KQZ-së, nuk do të bëhet i mundur në çdo qendër votimi ashtu siç ishte në proceset e kaluara zgjedhore. Ky lloj votimi do të mundësohet vetëm në qendrat e votimit të cilat do t'i caktojë KQZ-ja.

Ky ndryshim i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme është paraqitur me anë të një videomesazhi nga zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi. "Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme i miratuar në vitin 2023 ka bërë disa ndryshime lidhur me votimin me kusht. Votimi me

kusht është i mundur sërish, por ky lloj votimi nuk do të mundësohet në çdo qendër votimi ashtu siç ishte në proceset e kaluara zgjedhore. Në zgjedhjet e radhës për Kuvendin e Kosovës, KQZ-ja do t'i caktojë qendrat për votim me kusht. Lista e tyre do të publikohet në uebfaqen e KQZ-së dhe mjetet e tjera të informimit", thuhet në videon informuese të prezantuar nga Elezi.

Në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës të cilat janë mbajtur më 14 shkurt 2021, numri i qendrave të votimit në 38 komunat e Kosovës ishte 888 qendra votimi dhe në secilën prej tyre ishte i mundur votimi me kusht.



Shënohet një hap i rëndësishëm drejt forcimit të bashkëpunimit në mes të Kosovës dhe BERZh-it në projektet strategjike



PRISHTINË, 1 GUSHT - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, është takuar të enjten me drejtorin për Ballkanin Perëndimor të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh), Matteo Colangeli, si dhe drejtorin e BERZh-it për Kosovë, Sergiy Maslichenko. Në këtë takim ai shoqërohej nga ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati. Gjatë këtij takimi palët theksuan rëndësinë e lehtësimit të planifikimit, financimit dhe zbatimit të projekteve infrastrukturore, përfshirë këtu edhe parqet industriale që mundësojnë tërheqjen e

investimeve dhe zhvillimin e bizneseve në Kosovë.

Ky takim shënon një hap të rëndësishëm drejt forcimit të bashkëpunimit në mes të Kosovës dhe BERZh-it, duke synuar avancimin e projekteve strategjike që do të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të vendit dhe krijimin e mundësive të reja për bizneset vendase dhe ndërkombëtare. Kryeministri Kurti i falënderoi përfaqësuesit e BERZh-it për takimin dhe bashkëbisedimin e frytshëm, duke shprehur gatishmërinë e vullnetin për thellim të mëtejme të bashkëpunimit.

Kuvendi i Serbisë e miraton Deklaratën e "Kuvendit gjithëserb"

Prishtinë, 1 gusht - Kuvendi i Serbisë e ka miratuar të ashtuquajturën Deklaratë për mbrojtjen e të drejtave kombëtare dhe politike dhe të ardhmërisë së përbashkët të popullit serb, e cila doli nga një "Kuvend gjithëserb" muajin e kaluar në Beograd.

Deklarata - e miratuar më 8 qershor në Beograd në një takim të përbashkët të Qeverisë së Serbisë dhe asaj të Republikës Sërpska, entitetit serb të Bosnjë-Hercegovinës - përbëhet nga 49 pika dhe e përmend edhe Kosovën. Aty thuhet se populli serb "përbën një entitet të vetëm" dhe se, ndonëse "përgjatë historisë populli serb ka jetuar në shumë shtete me emra të ndryshëm, ai ka të drejtë ta ruajë traditën e tij të pasur".

Në takimin e 8 qershorit në Beograd ishte insistuar në, siç është thënë, "përdorimin e emrit të plotë të provincës jugore serbe - Kosova dhe Metohija" - si referencë për

shtetin e Kosovës.

Agjencia serbe e lajmeve "Beta" raporton se Deklarata u miratua me 139 vota për dhe u duartrokoi nga përfaqësuesit e qeverisë serbe. Nëntë deputetë votuan kundër, ndërsa asnjë nuk abstanoi.

Presidenti i Republikës Sërpska, Millorad Dodik, nuk ishte i pranishëm gjatë votimit, pavarësisht se ardhja e tij në Kuvendin e Serbisë për këtë ishte paralajmëruar. Kryetarja e Kuvendit të Serbisë, Ana Bërnabiq, kishte marrë pjesë në seancën e Asamblesë Kombëtare të Republikës Sërpska kur kjo e fundit e votoi Deklaratën në Banja Llukë në fillim të këtij muaji, raportoi portali N1.

Miratimi i kësaj Deklarate nga Republika Sërpska u dënua nga anëtarët e Presidencës së Bosnjë-Hercegovinës si dhe nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Sarajevë.



Skanimet me PET/CT, të kufizuara nga materiali shpenzues



PRISHTINË, 1 GUSHT - Ka më shumë se një muaj që në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) ka nisur të shfrytëzohet pajisja PET/CT për diagnostikimin dhe menaxhimin e llojeve të ndryshme të kancerit, por edhe të disa sëmundjeve të tjera. E siguruar për herë të parë në shkurt, kjo pajisje ofron shërbime të kushtueshme mijëra euro, të cilat, deri më tash, pacientët është dashur t'i paguajnë në institucione private ose jashtë vendit, ndërsa në QKUK i marrin falas. Sfidat, megjithatë, nuk mbarojnë këtu. QKUK-ja duhet ta sigurojë materialin e nevojshëm për PET/CT nga jashtë, pasi nuk e prodhon vetë. E materiali i tillë nuk ka jetë të gjatë, andaj kërkon transport të shpejtë dhe efikas.

Materiali shpenzues, sfidë

Për rrjedhojë, jo më shumë se pesë pacientë në javë mund të marrin shërbime me PET/CT. Lista e pritjes ka arritur tashmë deri në fund të gushtit. Drejtori i Shërbimit të Mjekësisë Nukleare në QKUK, Fakir Spahiu, tregon se materiali shpenzues për PET/CT, që përfshin izotopin radioaktiv, Flourine 18, sigurohet

nga Turqia. "Prodhuesi na furnizon një herë në javë. Kështu do të jetë për tre muaj, pastaj do ta rishqyrtojmë planin", thotë ai.

Duke folur për Radion Evropa e Lirë, ai thotë se sjellja në Kosovë e Flourine 18 është sfidë më vete, marrë parasysh se jetëgjatësia e kësaj substance është e shkurtër. Flourine 18 është një gjurmuese radioaktive, që injektohet në venë përpara procedurës me PET/CT, dhe e ndihmon profesionistin shëndetësor t'i shohë pjesët e trupit të pacientit.

Nëse nuk mbërrin me kohë dhe nuk ruhet në mënyrë të duhur, efektiviteti i saj humb, thotë Spahiu.

Ylli Kaçi, fizikan i mjekësisë nukleare në QKUK, tregon se gjysmë-jeta e izotopit Flourine 18 është 109.7 minuta, që do të thotë se pas kësaj periudhe ai përgjysmohet. Pra, çdo vonesë eventuale - qoftë e fluturimit të avionit apo e zhdoganimit të mallit - vjen me rrezikun e humbjes së efektivitetit, thotë ai.

Për mundësitë që Kosova ta prodhojë vetë këtë izotop, Kaçi thotë se ekzistojnë, porse, paraprakisht, duhet "rritja e resurseve humane dhe trajnimi adekuat i profesionistëve".

Prodhimi, shpjegon ai, bëhet nga një pajisje e quajtur ciklotron dhe

Kosova nuk ka mjaftueshëm ekspertë të kësaj fushe. "Shkollimi jashtë vendit i ekspertëve duhet të fillojë së paku një vit para se të startohet me prodhim, në mënyrë që të kemi garanci për kualitetin e produkteve finale", thotë Kaçi për Radion Evropa e Lirë.

Prodhimin e izotopit Flourine 18 nuk e bën as shumica e vendeve të rajonit.

Spahiu thotë se synim në punën e tij ka që Kosova ta arrijë këtë. Ai nuk ofron detaje se si dhe kur mund të prodhohet izotopi në fjalë, por vetëm përmend një "të ardhme të afërt". "... sepse një mjegull në aeroport, të cilën e kemi shpesh dimrit, shkakton probleme dhe materiali mund të mos arrijë në kohë", thotë Spahiu. Doza vetëm për një pacient, e cila arrin nga Turqia, kushton rreth 400 euro.

Barrën e këtyre shpenzimeve, së paku pacientët në QKUK nuk e ndiejnë.

Ditën kur ekipi i REL-it ishte atje, javën e kaluar, bisedoi me A.D., i cili po priste për të kryer procedurën me PET/CT.

I diagnostikuar me kancer kohë më parë, ai e kishte bërë një ekzaminim të tillë më herët jashtë vendit. "Kam shpenzuar 1.000 euro për PET/CT në Turqi. Tash po e bëj falas këtu në QKUK. Ma

kanë sugjeruar mjekët, pasi e kam kryer një pjesë të kimioterapisë", thotë A.D.

Përse është i rëndësishëm PET/CT?

Sipas Klinikës Mayo në ShBA, skanimi me PET/CT është një mënyrë efektive për zbulimin e disa sëmundjeve, përfshirë kancerin, sëmundjet e zemrës dhe çrregullimet e trurit.

Kur ka dyshime te një pacient, mjekët thonë se është e rëndësishme që skanimi me PET/CT të bëhet sa më parë, në mënyrë që të përcillet gjendja e pacientit dhe të përshkruhet terapia e duhur.

Kosova e ka siguruar pajisjen qysh në muajin shkurt - si donacion përmes Fondacionit Jahjaga - por ajo nuk është funksionalizuar deri muajin e kaluar.

Kjo, për faktin se objekti ku është vendosur PET/CT-ja, është dashur të licencohet nga Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore.

Përveç kësaj, edhe mjekët e teknikët është dashur të kryejnë trajnime të veçanta, përfshirë jashtë shtetit, për leximin e rezultateve të dala nga ekzaminimet me PET/CT. Përpara se QKUK-ja ta siguronte aparaturën, pacientët që kanë

pasur nevojë për të, i janë drejtuar një institucioni privat në Prishtinë, ku pagesa shkon mbi 1.000 euro, ose kanë dalë jashtë shtetit.

Më herët, REL-i ka biseduar me udhëheqësit e institucionit të lartpërmendur privat, të cilët kanë konfirmuar se materialin shpenzues për PET/CT e sigurojnë po ashtu nga Turqia.

Ata kanë thënë se duhet të bëhen së paku tre pacientë për këtë ekzaminim dhe pastaj ta porosisin materialin.

Fondi i Sigurimeve Shëndetësore i Kosovës i ka mbuluar shpenzimet e pacientëve për PET/CT, por ata është dashur të presin me javë, nëse jo muaj, për kryerjen e të gjitha procedurave deri te sigurimi i të hollave.

Radio Evropa e Lirë ka rastisur të bisedojë me disa pacientë që, për shkak të gjendjes urgjente, është dashur të paguajnë vetë.

Në Kosovë, sipas autoriteteve shëndetësore, çdo vit regjistrohen deri në 1.500 raste të reja me kancer. Forma më e përhapur është kanceri i gjirit te gratë dhe ai i mushkërive te burrat, ndërsa grup-mosha më e prekur nga kjo sëmundje është mbi 50 vjeç.

Mbi një muaj prej se QKUK-ja ka nisur skanimet me PET/CT, shërbimin e tillë e kanë marrë mbi 30 pacientë.

Filloi edicioni i tretë i Shkollës Verore Ndërkombëtare

PRIZREN, 1 GUSHT - Në kompleksin e Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren filloi edicioni i tretë i Shkollës Verore Ndërkombëtare që mbledh rreth 200 studentë nga vende të ndryshme.

Me program që ofron mundësi të shkëlqyera për zhvillim

akademik dhe profesional nga aftësitë e buta deri tek eksplorimi i diversitetit kulturor përmes filmit dokumentar, modulet e këtij edicioni premtojnë platformë për bashkëpunim dhe shkëmbim të përvojave.

Në këtë ngjarje ishin të

pranishëm edhe zëvendëskryeminstria Donika Gërvalla, ministri i Kulturës, Hajrulla Çeku, ministria e Arsimit, Arbërie Nagavci, e rektori i Universitetit të Prishtinës Qerim Qerimi, bashkë me rektorin e Universitetit "Ukshin Hoti", Mentor Alishani.



Mbahet mbledhja e Këshillit të Sigurisë së Kosovës, diskutohet për sigurinë në vend

PRISHTINË, 1 GUSHT - Me ftesë të kryeministrit Albin Kurti u mbajt mbledhja e Këshillit të Sigurisë së Kosovës, në të cilën u diskutua rreth situatës së sigurisë në vend, aktivitetet e institucioneve anëtarë të këtij mekanizmi dhe planifikimet për periudhën në vijim. Përveç të tjerash, në takim u

diskutuan edhe çështje të përgjithshme të sigurisë publike dhe sfidat aktuale të ndërlidhura me zjarret dhe sigurinë në komunikacion. Në njoftimin e qeverisë thuhet se institucionet e Republikës së Kosovës në bashkërendim i kanë shtuar aktivitetet e tyre për të parandaluar, por edhe

mbajtur në kontroll përhapjen e zjarreve, si dhe masat e tjera në shërbim të rritjes së sigurisë në komunikacion. "Ato do t'i shtojnë përpjekjet e tyre edhe në kuadër vetëdijesimit të qytetarëve për parandalimin e përhapjes së zjarreve dhe sigurisë së shtuar në trafik", ka njoftuar Qeveria e Kosovës.



Qeveria realizoi vetëm 33 % të Planit Kombëtar për zhvillim për periudhën janar - qershor 2024

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 1 GUSHT - Lëvizja Fol ka publikuar të dhënat nga monitorimi i Planit Kombëtar për Zhvillim për periudhën janar - qershor 2024.

Mexhide Demolli-Nimani, drejtoreshë në Lëvizjen Fol, tha se edhe këtë vit Foli ka bërë monitorimin e aktiviteteve të parapara në Planin Kombëtar për Zhvillim. "Qeveria e Kosovës nga 147 aktivitete të parapara të realizohen brenda periudhës janar - qershor 2024, ka arritur të realizojë vetëm 49 apo 33 % prej tyre, ndërkaq 59 apo 40 % prej tyre kanë mbetur të porealizuara. Ndërsa për 39 aktivitete apo (27 %) nga tri ministri (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit), Foli nuk ka pranuar përgjigje se sa janë realizuar aktivitetet e tyre për periudhën e parë gjashtë mujore", ka theksuar ajo.

Demolli-Nimani listoi dhe ministrinë të cilat s'kanë planifikuar asnjë aktivitet për periudhën e parë gjashtëmujore 2024: Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Ministria e Zhvillimit Rajonal, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim.

Ndërkaq Burbuqe Kastrati, menaxhere e projektit në Lëvizjen Fol, ka prezantuar të dhënat për secilën ministri sa i përket realizimit të aktiviteteve të parapara të përfundojnë brenda periudhës janar - qershor të vitit 2024. Sipas të dhënave të Fol-it, Zyra e Kryeministrit kishte paraparë vetëm 16 aktivitete të realizohen gjatë periudhës janar - qershor 2024 në kuadër të Planit Kombëtar për Zhvillim, nga to



janë realizuar 13 dhe 3 kanë mbetur pa u realizuar.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në kuadër të Planit Kombëtar për Zhvillim ka paraparë të përfundojë 8 aktivitete brenda periudhës janar - qershor 2024. Prej tyre kanë realizuar 6, ndërkaq 2 janë të porealizuara.

Ministria e Drejtësisë në kuadër të Planit Kombëtar për Zhvillim ka paraparë të përfundojë 36 aktivitete brenda periudhës janar-qershor 2024. Vetëm 14 janë përfunduar brenda afatit të paraparë, ndërkaq 22 janë të papërfunduara.

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në kuadër të Planit Kombëtar për Zhvillim ka paraparë të

përfundojë 3 aktivitete brenda periudhës janar - qershor 2024, prej të cilave ka realizuar 1 dhe 2 të tjera janë të porealizuara.

Ministria e Ekonomisë në kuadër të Planit Kombëtar për Zhvillim ka paraparë të përfundojë 18 aktivitete brenda periudhës janar - qershor 2024. Vetëm 6 janë realizuar brenda afatit të paraparë, ndërkaq 12 janë të porealizuara.

Ministria e Punëve të Brendshme në kuadër të Planit Kombëtar për Zhvillim ka paraparë të përfundojë 10 aktivitete brenda periudhës janar - qershor 2024. Vetëm 6 janë përfunduar brenda afatit të paraparë, ndërkaq 4 janë të porealizuara.

Ministria e Mbrojtjes ka paraparë të realizojë vetëm një aktivitet

gjatë periudhës janar-qershor 2024 në kuadër të Planit Kombëtar Zhvillimor i cili ka mbetur i porealizuara.

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë nga 15 aktivitete të parapara të realizohen gjatë periudhës janar-qershor 2024, ka realizuar 3 dhe 12 kanë mbetur të porealizuara.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka paraparë të realizojë vetëm 1 aktivitet gjatë periudhës janar-qershor 2024 në kuadër të Planit Kombëtar Zhvillimor i cili ka mbetur i porealizuara.

Ndërkaq tri ministri nuk janë përgjigjur në pyetësorin e Lëvizjes Fol dhe nuk dimë nëse i kanë realizuar aktivitetet e parapara apo jo.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në kuadër të Planit Kombëtar për Zhvillim ka paraparë të realizojë 11 aktivitete brenda periudhës janar - qershor 2024.

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve në kuadër të Planit Kombëtar Zhvillimor ka paraparë të përfundojë 9 aktivitete brenda periudhës janar-qershor 2023.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në kuadër të Planit Kombëtar Zhvillimor ka paraparë të përfundojë 19 aktivitete brenda periudhës janar - qershor 2024.

Ajo çka duhet theksuar është se Foli ka bërë monitorimin e aktiviteteve të parapara të përfundojnë vetëm gjatë periudhës së parë gjashtë mujore (janar - qershor 2024).

Sipas Demolli-Nimanit, Lëvizja Fol ka bërë krahasimin ndër vite të realizimit të aktiviteteve në kuadër të Planit Kombëtar Zhvillimor të parapara të përfundojnë në periudhën janar - qershor për vitet 2022, 2023, 2024.

Në vitin 2022 niveli i zbatimit të Planit të Punës së Qeverisë ka rezultuar të jetë 48 %, ndërsa në vitin 2023 Qeveria e Kosovës ka realizuar 34 % dhe në vitin 2024 ky plan është realizuar vetëm 33 % për periudhën e parë gjashtëmujore.

Mirëpo për dallim nga gjashtëmujori i parë i vitit 2022 ku kanë qenë të planifikuara 2077 aktivitete, në vitin 2024 kanë qenë vetëm 147, pra 1930 aktivitete më pak se në vitin 2022. Gjithashtu, për periudhën e njëjtë në vitin 2022 janë realizuar 1 032 aktivitete më shumë se në vitin 2024. Nga të dhënat e mësipërme del se puna e qeverisë ka pësuar rënie në zbatimin e këtij plani në tri vitet e fundit.

Njohësi i sigurisë bën thirrje që të merren masa ligjore për zjarrvënien në fusha dhe pyje

PRISHTINË, 1 GUSHT - Tahir Ahmeti, njohës i çështjeve të emergjencave civile, ka theksuar se duhet të merren masa ligjore për zjarrvënien në fusha dhe pyje. "Institucionet përgjegjëse duhet me kohë të bëjnë fushata vetëdijesuese, gjithëpërfshirëse, duke

paralajmëruar qytetarët për rrezikun nga zjarret, por edhe për sanksionet ndëshkuese nga shkaktimi i zjarreve të qëllimshme. Duke u bazuar në ligjet e Republikës së Kosovës, inicimi i zjarrit që është me rrezik të përgjithshëm është vepër penale dhe

sanksionohet me burgim. Organet e rendit në Kosovë duhet të jenë shumë më aktive në terren në mënyrë që të gjithë ata që shkaktojnë zjarrvënien, qoftë të qëllimshme apo nga pakujdesia, t'i marrin ndëshkimet e duhura ligjore", ka thënë Ahmeti.



Kryetari Kastrati ua dha çmimin “Qytetar Nderi” i Malishevës personaliteteve amerikane David Carr, Charles D. Fall dhe Naser Nika



Sot, në një ceremoni të organizuar nga komuna e Malishevës, në mënyrë solemne iu dha çmimi “Qytetar Nderi” tri personaliteteve amerikane nga shteti i Nju-Jorkut, David Carr, anëtar i Këshillit të shtetit të Nju-Jorkut, Charles D. Fall, anëtar i Asamblesë së shtetit të Nju-

Jorkut dhe veprimtarit të njohur, Naser Nika. Këtë çmim këtyre personaliteteve u dorëzoi kryetari i komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati, me motivin “për kontributin dhe përkrahjen e jashtëzakonshme për komunitetin shqiptar në Nju-Jork të Shteteve të Bashkuara të Amerikës”.

Në fjalën e rastit, i pari i komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati, ka thënë se “falë kontributit të ShBA-së, Kosova sot është e pavarur dhe e lirë”. Ndërsa duke vlerësuar përkrahjen e ShBA-së dhe të këtyre personaliteteve në Nju-Jork për Kosovën, tha se “miqësia mes Kosovës dhe ShBA-së është vëllazëri e

përrjetshme. Falë kontributit të tyre, se festa e Kosovës njihet në Nju-Jork, ndërsa edhe rrugët mbajnë emra të figurave shqiptare”. “Jam i nderuar në vazhdimësi me lidhjet tona shpirtërore që kombi shqiptar ndërtoi me shekuj të tërë me ShBA-në dhe kontributi i saj e bën Kosovën më të fortë dhe të pavarur. Jam i nderuar që të

ndaj çmimet ‘Qytetar Nderi’ për të gjitha çështjet që ju ngrehet në Nju-Jork dhe për përkrahjen e vazhdueshme. Falë jush dy festa të Kosovës njihen në dy institucione në Nju-Jork. Davidi ka kërkuar që një rrugë në Nju-Jork të quhet Ismail Qemali. Po ashtu, edhe një rrugë me emrin Isa Boletini. Miqësia dhe aleanca jonë nuk





është e rastësishme, por është vëllazëri e përrjetshme". "Populli shqiptar e kujton kontributin historik të tyre. Në këtë angazhim nuk duhet ta harrojmë diasporën që jep kontribut për shqiptarët. Nuk harrojmë kontributin e presidentëve të ShBA-së. Sot është një moment gëzimi dhe krenarie për Malishevën. Kjo komunë është shembull i lirisë dhe i nderit", ka thënë kryetari Kastrati në ceremoninë e

sotme. Vendimin e Kuvendit të Komunës për shpalljen "Qytetar Nderi" për tri personalitetet amerikane e ka lexuar kryesuesi i KK të Malishevës, Argjend Thaçi, si dhe biografinë e secilit. Pas marrjes së çmimit, të tri personalitetet nga Nju-Jorku shprehën kënaqësinë e tyre për marrjen e këtij çmimi dhe nga sot e konsiderojnë veten banorë të komunës së Malishevës dhe

se ndihen shumë të nderuar dhe të respektuar.

"Jam me të vërtetë i nderuar për këtë çmim që mora sot dhe dua ta falënderoj kryetarin e komunës për të gjitha këto që po i bën për komunitetin shqiptar në Nju-Jork", tha Charles D. Fall, ndërsa David Carr tha se "të pranoj një çmim të tillë do të thotë gjithçka për mua. Kam ardhur për disa arsye dhe njëra prej tyre është se edhe pse jemi dy amerikanë

të partive të ndryshme ne bashkohemi dhe do të jemi gjithmonë miqtë tuaj".

Më i emocionuar ishte aktivisti Naser Nika, një shqiptar-amerikan, që gjithë jetën ia kushtoi çështjes kombëtare dhe falë angazhimit të tij, edhe festa e pavarësisë së Kosovës njihet zyrtarisht në shtetin e Nju-Jorkut. "Është shumë të vështirë të flas sepse kemi marrë çmimin më të lartë. Jemi bërë bashkë dhe jemi munduar

të punojmë për Kosovën. Të tre neve do të na keni ambasadorë të Malishevës në Nju-Jork. Jam qytetar juaji nga dita e sotme", tha Nika, i cili falënderoi edhe Fatmir Limajn për përkrahjen e vazhdueshme.

Më pas delegacioni nga Nju-Jorku ka vizituar edhe Varrezat e Dëshmorëve në Malishevë dhe Kleçkë dhe ka bërë nderime dhe homazhe pranë varreve të dëshmorëve të rënë për lirinë e Kosovës.



Qeveria i kërkon menaxhmentit të Trepçës t'i ulë shpenzimet dhe ta rrisë prodhimin

PRISHTINË, 1 GUSHT - Qeveria e Kosovës ka thënë të enjten se është e përkushtuar për ta përkrahur ndërmarrjen "Trepça" dhe të gjitha ndërmarrjet e tjera publike. "Përkrahja nënkupton mbështetje për zhvillim dhe rritje të potencialit të plotë ekonomik. Nga ndërmarrjet dhe udhëheqja e tyre, Qeveria e Republikës së Kosovës pret marrjen e masave që rrisin kontrollin e brendshëm operativ e financiar, si dhe reforma rrënjësore që transformojnë afarizmin e tyre. Pavarësisht prej mbështetjes që qeveria i ka dhënë gjatë gjysmës së parë të këtij viti, ndërmarrja 'Trepça Sh. A.' ka operuar me humbje si rezultat i ngecjeve në prodhim dhe të hyrave të pamjaftueshme", ka njoftuar qeveria.

Sipas këtij njoftimi, Ministria e Ekonomisë ka përkrahur ndërmarrjen me subvencione në

vlere prej 3.3 milionë eurosh, që është përtej shumës së planifikuar për të gjithë vitin. "Megjithatë, këto mjete nuk u kanë mjaftuar për ta siguruar mbulimin e shpenzimeve operative dhe pagave të punonjësve, që përbëjnë pjesën e konsiderueshme të shpenzimeve të ndërmarrjes. Ministria e Ekonomisë në mënyrë të vazhdueshme ka inkurajuar menaxhmentin e ndërmarrjes për t'i optimizuar shpenzimet. Së fundmi, me pranimin e kërkesës së ndërmarrjes për ndarjen e mjeteve financiare shtesë, Ministria e Ekonomisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës kanë kërkuar nga bordi dhe menaxhmenti të prezantojnë një plan veprimi", theksohet në njoftimin e qeverisë.

Qeveria ka thënë se presin që të adresohen në mënyrë të qartë, efektive dhe të qëndrueshme sfidat e ndërmarrjes Trepça. "Në



veçanti, Qeveria e Republikës së Kosovës pret nga ndërmarrja të sigurojë rritje të prodhimit të të hyrave dhe ulje të shpenzimeve, si mënyra e vetme për të arritur stabilizim të gjendjes operative dhe financiare të ndërmarrjes dhe

kompensim të rregullt të punonjësve në mënyrë të qëndrueshme. Qeveria e Republikës së Kosovës mbetet në komunikim të vazhdueshëm me bordin e ndërmarrjes. Sigurojmë se të gjitha palët janë të

angazhuara maksimalisht për një zgjidhje afatgjatë në përputhje me kompetencat ligjore dhe përgjegjësitë e tyre. Njëkohësisht, qeveria është duke trajtuar planin e propozuar nga ndërmarrja "Trepça Sh. A." Përkrahja financiare varet nga plani dhe zotimi konkret që do të ulen shpenzimet dhe do të rifillojë rritja e prodhimit", thuhet në njoftimin për medie të qeverisë.

Qeveria e Kosovës ka theksuar se janë të bindur se me një bashkëpunim të ngushtë dhe përkushtim të përbashkët mund të arrihen përmirësime të ndjeshme dhe rezultate pozitive për ndërmarrjen "Trepça" dhe për të gjithë punonjësit e saj. "Nuk ekziston asnjë rrugë tjetër përpos punës dhe angazhimit intensiv, rregullit, kontrollit dhe drejtimit të përgjegjshëm të ndërmarrjes për sukses", thuhet në njoftimin e qeverisë.

Osmani viziton Odën Ekonomike Amerikane, potenciali ekonomik dhe fuqizimi i dialogut publiko-privat, temë diskutimi

PRISHTINË, 1 GUSHT - Promovimi i koordinuar i potencialeve ekonomike të Kosovës dhe fuqizimi i dialogut publiko-privat ishin në thelb të diskutimit gjatë një takimi që presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, mbajti me strukturat udhëheqëse të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë.

Duke folur para anëtarëve të Bordit të Guvernatorëve dhe anëtarëve të Këshillit Drejtues të Qendrës së Arbitrazhit të Odës Amerikane, presidentja Osmani theksoi rëndësinë e dialogut publiko-privat si proces në të mirë të Kosovës e në shërbim të zhvillimit ekonomik të Kosovës. Në ndërlidhje me këtë, ajo inkurajoi përfshirjen aktive të



sektorit privat përmes ofrimit të rekomandimeve konkrete. Referuar njoftimi të OEAK ajo tutje tha se dera e Zyrës së Presidentes do të jetë përherë e hapur për përfaqësuesit e sektorit privat, duke demonstruar vullnetin e saj për përkrahje dhe

përpjekje të koordinuara. Presidentja tha se duke e fuqizuar sektorin privat në vend, e bëjmë atë edhe më atraktiv në aspektin e punësimit. Duke folur për popullsinë e Kosovës, e cila vijon të jetë popullsia më e re në moshë në

Kosovë, presidentja Osmani tha se kapitali njerëzor është aseti më i rëndësishëm i Kosovës.

Në ndërlidhje me këtë, presidentja theksoi nevojën e investimit në zhvillimin e vazhdueshëm të kapitalit njerëzor. Presidentja foli edhe për rolin dhe kontributin e jashtëzakonshëm të mërgatës në zhvillimin ekonomik të Kosovës. Në takimin në të cilën morën pjesë edhe përfaqësues të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), presidentja Osmani foli edhe për kontributin e tejmuar të ShBA-së në fuqizimin ekonomik, por edhe subjektivitetin ndërkombëtar, përfshirë edhe anëtarësimin në

organizata të rëndësishme e konventa ndërkombëtare.

Duke folur për sektorin e drejtësisë në vend, presidentja tha se progresi në aspektin ekonomik e social do të duhej përcjellë edhe me fuqizimin e vazhdueshëm të sektorit të drejtësisë si në aspekt të profesionalizimit, po ashtu edhe në atë të integritetit, në mënyrë që sektori privat dhe segmentet e tjera të shoqërisë të mund ta rrisin besimin në institucionet e drejtësisë dhe promovimin e parashikueshmërisë ligjore. Presidentja Vjosa Osmani foli edhe për rëndësinë e koordinimit të përpjekjeve për promovimin e potencialeve për investime në Kosovë.


Mbi një miliard euro të mbledhura nga Dogana

PRISHTINË, 1 GUSHT - Dogana e Kosovës ka arritur sukses historik, pasi ka mbledhur mbi një miliard euro të hyra. Kjo arritje përfaqëson një pikë të rëndësishme për institucionin dhe për ekonominë e vendit tonë, duke reflektuar përpjekjet e vazhdueshme për t'i përmirësuar proceset dhe për ta rritur efikasitetin e shërbimeve. Vlen të theksohet se qe nga themelimi i Doganës e deri sot kjo është hera e parë që më 1 gusht arrihet kjo shumë.

Ky rekord i ri është rezultat i një kombinimi faktorësh, duke përfshirë përmirësimin e procedurave doganore: Implementimi i sistemeve të reja dhe teknologjive për të thjeshtuar dhe shpejtuar proceset doganore ka luajtur një rol kyç në arrijten e këtij suksesi; Lufta kundër kontrabandës dhe evazionit fiskal: Masat e intensifikuara dhe bashkëpunimi me agjencitë tjera të zbatimit të ligjit kanë kontribuar në uljen e kontrabandës dhe evazionit fiskal, duke rritur të hyrat;

Transparenca dhe edukimi publik: Rritja e ndërgjegjësimit publik dhe edukimi i qytetarëve dhe bizneseve për rëndësinë e përputhshmërisë me ligjet doganore ka rezultuar në një përputhshmëri më të lartë dhe, rrjedhimisht, në të hyra më të larta.

Drejtori i përgjithshëm i Doganës së Kosovës, Agron Llugaliu, shprehu mirënjohjen për stafin e Doganës dhe për partnerët strategjikë që kanë ndihmuar për arrijten e këtij suksesi. "Ky është një moment i rëndësishëm për Doganën e



Kosovës dhe për të gjithë qytetarët e vendit tonë. Mbledhja e 1 miliard eurove të hyra është dëshmi e punës së

palodhshme, përkushtimit dhe profesionalizimit të Doganës së Kosovës", ka thënë Llugaliu.

Lufta në prag! Ajatollah Khamenei ka urdhëruar goditjen e Izraelit



Gjatë funeralit të liderit politik të Hamasit, Ismail Haniyeh, disa liderë politikë të Republikës Islamike përsëritën thirrjet për hakmarrje ndaj Izraelit, i konsideruar përgjegjës për sulmin që e vrau. Udhëheqësi suprem Ayatollah Ali Khamenei u lut për Haniyeh pasi kërcënoi me “dënim të ashpër”.

Të pranishëm në varrim ishin Presidenti Pezeshkian dhe kreu i Gardës Revolucionare Islamike, gjeneral Hossein Salami. Khalil al-Hayya, kreu i marrëdhënieve me jashtë të lëvizjes, premtoi gjatë ceremonisë së varrimit se “slogani i Ismail Haniyeh, ‘Ne nuk do ta njohim Izraelin’, do të mbetet një slogan i pavdekshëm” dhe se “ne do ta persekutojmë Izraelin derisa të çrrënjohet nga toka e Palestinës”.

Kryetari i parlamentit iranian, Mohammad Bagher Galibaf tha se Irani “do të zbatojë patjetër urdhrin e liderit suprem për t’u hakmarrë për Haniyeh: është detyra jonë të përgjigjemi në kohën e duhur dhe në vendin e duhur,” tha ai në një fjalim para turmës që brohoriste “Vdekje

Izraelit, Vdekje Amerikës!”. Khamenei, i cili ka fjalën e fundit në çështjet politike të Iranit, tha: “Është detyra jonë të kërkojmë hakmarrje”.

New York Times: Ajatollah Ali Khamenei ka dhënë urdhrin për të goditur Izraelin

Udhëheqësi suprem i Iranit, Ayatollah Ali Khamenei, ka dhënë urdhrin për të goditur drejtpërdrejt Izraelin si hakmarrje për vrasjen e kreut të byrosë politike të Hamasit, Ismail Haniyeh, në Teheran. Kështu raporton New York Times, duke cituar tre zyrtarë iranianë.

Është e paqartë se sa me forcë do të përgjigjet Irani dhe nëse do të kalibrojë edhe një herë sulmin e tij për të shmangur një përshkallëzim, siç ndodhi prillin e kaluar. Sipas burimeve me të cilat foli NYT, komandantët ushtarakë iranianë po shqyrtojnë një tjetër sulm të kombinuar me dron dhe raketa

ndaj objektivave ushtarake në afërsi të Tel Avivit dhe Haifës, duke u siguruar që të shmangin objektivat civilë. Një tjetër opsion është një sulm i koordinuar nga Irani dhe nga frontet e tjera, duke përfshirë Jemenin, Sirinë dhe Irakun. Komandanti i përgjithshëm i forcave të armatosura, ka udhëzuar komandantët ushtarakë të Gardës Revolucionare dhe ushtrisë për të përgatitur plane si për sulm ashtu edhe për mbrojtje, nëse lufta zgjerohet dhe Izraeli ose Shtetet e Bashkuara godasin Iranin.

Izraeli i dërgon një mesazh Hezbollahit

Pas vrasjes së Fuad Shukur, komandant i rangut të lartë të Hezbollahit, Izraeli i përcolli një mesazh grupit shiit nëpërmjet diplomatëve perëndimorë, se sulmet në shkallë të gjerë ndaj civilëve izraelitë do të çojnë në një luftë të plotë. Kjo është bërë e ditur nga faqja izraelite e lajmeve “Ynet”. Sipas këtij burimi,

mesazhi i dërguar grupit pro-iranian vinte në dukje se Izraeli kishte në shënjestër komandantët dhe luftëtarët e grupit shiit dhe jo infrastrukturën e tij, dhe pritshmëria ishte që Hezbollahu të shënjestrojë vetëm personelin ushtarak izraelit. Izraeli po përgatitet për hakmarrje pasi komandanti i lartë i Hezbollahit Shukur u vra në një sulm në periferi të Bejrutit, duke u bërë figura më e lartë e grupit që ekzekutohet në gati 10 muaj konflikt me Izraelin.



Washington Post: “SHBA mobilizon 12 anije luftarake në Lindjen e Mesme”

Shtetet e Bashkuara kanë mobilizuar 12 anije luftarake në Lindjen e Mesme në mes të tensioneve në rritje midis Izraelit, Libanit dhe Iranit, raportoi Washington Post, duke cituar një burim nga Pentagoni. Anijet – përfshirë aeroplanmbajtësen USS Theodore Roosevelt –

ndodhen tashmë në Gjirin Persik, Mesdheun Lindor dhe Detin e Kuq.

Blinken: “U bëj thirrje të gjitha palëve, shmangni përshkallëzimin”

Sekretari amerikan i Shtetit Antony Blinken lëshoi një apel nga Mongolia për t’i dhënë fund përshkallëzimit në Lindjen e Mesme. Pas vrasjes së liderit politik të Hamasit, Ismail Haniyeh në Teheran dhe kërcënimeve për një përgjigje të ashpër nga Irani, Blinken u bëri thirrje “të gjitha palëve” të ndalojnë “veprimet përshkallëzuese” dhe të vendosin për një armëpushim në Gaza. Arritja e paqes, tha kreu i diplomacisë amerikane në pjesën mongole të turneut të tij në Azi, “fillon me një armëpushim dhe, për të arritur atje, është e nevojshme së pari që të gjitha palët të bisedojnë dhe të ndalojnë ndërmarrjen e çdo veprimi përshkallëzues”. / bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Loriana Kuka pensionohet pas eliminimit nga Lojërat Olimpikë

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 1 GUSHT - Xhudistja nga Kosova Loriana Kuka ka humbur në ndeshjen e dytë në Lojërat Olimpikë "Paris 2024", duke u eliminuar nga këto lojëra. Loriana i ka nisur pozitivisht garat në Paris, duke fituar ndeshjen e parë, por ishte e pafat duke humbur ndeshjen e dytë. Pas eliminimit të Lorianës ka reaguar trajneri, njëherësh xhaxhai i saj Driton Kuka, i cili paralajmëroi pensionimin e Lorianës nga sporti i xhudos. Kuka ka thënë se mbesa e tij e braktisi Zvicrën për të arritur suksese kulmore në sportin e xhudos. "Dy fjalë për Lorin... La Zvicrën tash e 8 vjet për të arritur ëndrrat e saj për medalje elitare! Fitoj medalje nga Kampionatet Evropiane e Botërore, e deshe edhe Olimpikë por fati se deshi! Erdhe nga Zvicra duke treguar se je gjaku ynë dhe deshe të bëje krenar familjen, ekipin dhe Kombin Shqiptar! Dëshira jote e madhe ishte të arrije sukseset që i arrite për babin tënd, vëllaun tim Sylën që me aq pasion e mbollti dashurinë për sportin e xhudos tek unë, Agroni dhe mbarë familja jonë! Falë teje vëlla, jam në xhudo, falë teje që ishe trajneri im dhe idoli im i jetës! Si axha yt Lori të uroj fatin e botës në jetën tende tash e tutje, në rugëtimin e ri jetësor! Faleminderit për krejt", ka shkruar Kuka.

Më pas lajmin për pensionimin e

xhudistes Kuka e konfirmoi Komiteti Olimpik i Kosovës përmes një postimi në faqen zyrtare. "Loriana Kuka mbyll karrierën e suksesshme në xhudo. Krenarë me ty! Mirënjohës për gjithçka që i dhatë sportit të Kosovës", thuhet në njoftimin e KOK-ut.

Ndërsa xhudistja Loriana Kuka që ka pasur një rrugëtim të suksesshëm në xhudo gjatë karrierës së saj, duke fituar medalje evropiane, botërore, medaliste e Lojërave Evropiane, dy herë pjesëmarrëse në Lojërat Olimpikë, si dhe ishte edhe medaliste e Lojërave Mesdhetare, ka thënë se në "Paris 2024" ka garuar e lënduar dhe se fati nuk deshi që kualifikohet në çerekfinale. "E kom nis ditën shumë mirë, kam qenë shumë e fokusuar dhe jam shumë e lumtur që kam arritur së paku luftën e parë ta fitojë. Në luftën e dytë kam qenë gjithashtu e koncentruar, e kam ditë se çfarë duhet të bëjë, por fati nuk deshi që të shkojë deri në çerekfinale", ka thënë 27-vjeçarja. "Kom garuar me plotë lëndime dhe për këtë jam shumë krenare çfarë kam arritur deri sot, që kam garuar deri sot me lëndime dhe nuk jam ndal asnjëherë. Kjo ka qenë gara e fundit për mu, kam dashur ta përfundoj më mirë normalisht, por jam krenare për çfarë kam arritur deri tash", ka deklaruar Loriana Kuka. Duhet cekur se Distria Krasniqi ka fituar medaljen e argjendtë në "Paris

2024", ndërsa Laura Fazliu të bronzitën.

Ekipi olimpik i xhudos mbyll Lojërat Olimpikë me dy medalje

Federata e Xhudos së Kosovës është shprehur e lumtur me arritjet e ekipit të xhudos në Lojërat Olimpikë "Paris 2024". Kosova në këtë Olimpiadë arriti të sigurojë dy medalje olimpikë - një të argjendtë dhe një të bronzitë. Me këto arritje, Kosova tani ka gjithsej pesë medalje olimpikë. "E mbi të gjitha, Distria, Laura, Akili, Loriana dhe Nora na falën emocione të jashtëzakonshme", thuhet në postimin e FXhK-së. Nën drejtimin këmbëngulës të trajnerëve Driton Kuka dhe Majlinda Kelmendi, bashkë me xhudistët tanë të talentuar, Kosova vazhdon traditën dhe përkushtimin në xhudo. Kosova sot është midis vendeve të dëshmuara në sportin e xhudos, edhe në arenën ndërkombëtare.

Rezultatet finale të xhudistëve kosovarë në 'Paris 2024'

Distria Krasniqi (-52kg) medalje të argjendtë
 Laura Fazliu (-63kg) medalje të bronzitë
 Akil Gjakova (-73kg) vendin e pestë
 Loriana Kuka (-78kg) vendin e nëntë
 Nora Gjakova (-57kg) vendin e shtatë

SHKURT

Seminar njëditor me instrukturin Klaus Stark

Shoqata e Trajnerëve të Futbollit organizon seminar njëditor me trajnerët e Superligës dhe Ligës së Parë (femra dhe meshkuj) me ligjërues instrukturin gjerman Klaus Stark. Tema e seminarit do të jetë "Sistemet e lojës (përparësitë dhe mangësitë) dhe aplikimi i tyre në praktikë". Seminari mbahet më 8 korrik, në orën 9:30, në Kampin Nacional në Hajvali. "Trajnerët e interesuar që dëshirojnë të marrin pjesë duhet ta dërgojnë kërkesën e tyre në adresën e emailit: departamentiteknik@ffk-kosova.com", thuhet në njoftimin e FFK-së.

Shaqiri rikthehet në stërvitje me ekipin e Chicago Fire

Xherdan Shaqiri i është bashkuar në stërvitje skuadrës së Chicago Fire. Trajneri Frank Klopas e ka mirëpritur Shaqirin, ndërsa shpreson ta ketë sa më shpejt në dispozicion. "Gjëja e mirë është që po kthehen disa djem të shëndetshëm ose të disponueshëm për lojë, por jo për ndeshjen e Kupës së Ligës. Uroj të jemi në finale të Kupës së Ligës që t'i kemi në dispozicion të gjithë lojtarët sepse kemi nevojë për të gjithë", ka thënë trajneri Klopas. Ai nuk do të paraqitet në Kupën e Ligës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës kundër Tolucas të premtën. Shaqiri u largua nga Chicago në qershor për t'iu bashkuar Zvicrës në përgatitje për Evropianin që u zhvillua në Gjermani. 32-vjeçari me Chicago ka kontratë deri në fund të vitit. Ai mund të kthehet të luajë sërish në Evropë nga janari i vitit të ardhshëm.

Formacioni më i mirë i Kupës së Amerikës

Pas përfundimit të Kupës Amerikës të fituar nga Argjentina, organizatorët e kompeticionit kanë shpallur formacionin më të mirë. Në këtë 11-she dominon Argjentina me gjithsej pesë futbollistë, finalistja Kolumbia dy. Kanadaja, Ekuadori, Uruguai dhe Brazili kanë nga një futbollist. Në portë është Emiliano Martinez dhe përballë tij katërshja në mbrojtje janë Johnston i Kanadasë, kampioni Romero, Davinson Sanchez i Kolumbisë dhe Hincapie i Ekuadorit. Në mesfushë emrat e Rodrigo de Paul nga Argjentina, Manuel Ugarte nga Uruguai dhe lojtari më i mirë i zgjedhur i turneut - James Rodriguez. Në sulm janë Lionel Messi, Lisandro Martinez, i cili u bë golashënuesi më i mirë i kompeticionit dhe anësori brazilian Rafinha.

Verstappen: Nuk më intereson e ardhmja e Perezit, jam i shqetësuar për makinë

Milton Keynes, 1 gusht - Max Verstappen e nisi garën e fundit të Formula 1 zhvilluar në Belgjikë nga vendi i 11-të pas penalizimit me 10 vende dhe e mbylli atë në vendin e katërt, pozicion që e fitoi pas shkualifikimit të George Russellit. "Rezultati është pozitiv për kampionatin, por

kemi ende shumë punë për të bërë", u shpreh piloti holandez, tri herë kampion bote në Formula 1 dhe kryesues i këtij botërori me makinën Red Bull. Te Red Bulli fitorja mungon prej disa garash, edhe për shkak se piloti tjetër Sergio Perez ka zhgënjyer. Aq sa përfillet se

mund të mos garojë me Red Bullin pjesën e dytë të sezonit, por te makinat satelit RB. I pyetur për të ardhmen e Perezit, piloti holandez u shpreh indiferent: "Mendimi im vlen deri në një pikë të caktuar. Besoj se shqetësimi ynë më i madh duhet të jetë makina

dhe jo partneri im në garazh". "Shpresoj që pas pushimeve makina Red Bull të jetë më e shpejtë, pasi tani jemi pas McLarenit e Mercedesit. Duhet ndryshuar patjetër trendi, pasi kështu mund të rrezikojmë shumë në të ardhmen", ka deklaruar Verstappen.



Curry: Lojërat Olimprike janë më shumë se basketboll

PARIS, 1 GUSHT - Kombëtarja amerikane e basketbollit siguroi kualifikimin në çerekfinalet e Olimpiadës pas fitores ndaj Sudanit Jugor, me dy fitore në po kaq ndeshje të luajtura. Ndërkohë që, kombëtarja e "Dream Team" ka ende edhe një sfidë për të luajtur në Porto Rikos, që është një formalitet për yjet e NBA-së. Për herë të parë merr pjesë në një Olimpiadë ylli i basketbollit Stephen Curry, 4 tituj kampionë në NBA me Golden State Warriors. Çdo ditë qindra admirues dhe gjuetarë autografesh mbledhen për t'i takuar yjet e kombëtares së trajnerit Steve Kerr, që synon ta fitojë medaljen e artë olimprike në "Paris 2024". Në karrierën e tij të pabesueshme ai fitoi gjithçka, vendosi rekorde që do të zgjasin dhe në një farë mënyre ndryshoi lojën e basketbollit. Një medalje në Lojërat Olimprike është e vetmja gjë që i mungon 36-vjeçarit. "E kisha pritur me vite këtë moment. Lojërat



Olimprike janë shumë më tepër sesa thjesht basketboll", ka thënë Curry. "Ndiej përgjegjësinë dhe krenarinë për të luajtur me shokë të jashtëzakonshëm. Është një mundësi që nuk do të përsëritet më. Për mua është kënaqësi që rikthehem në kombëtare. Para ndeshjes kundër Serbisë isha pak nervoz, më pas e dëgjova himnin dhe ishte i bukur", u shpreh

Stephen Curry për mediet. "Ndoshta do të jetë eksperiencia ime e vetme në Olimpiadë, prandaj dua medaljen e artë. E di që nuk do të jetë një shëtitje në park, pasi këtu janë ekipe kombëtare të gatshme, me plot lojtarë të mëdhenj. Ne duhet të krijojmë diçka së bashku dhe nuk kemi një vit për ta bërë atë, por vetëm disa ditë", ka deklaruar Curry.

Ancelotti pas humbjes nga Milani: Skuadra po rritet, fokusohemi te Barcelona

MADRID, 1 GUSHT - Carlo Ancelotti foli në konferencën për shtyp pas humbjes 1-0 që Reali i tij regjistroi në miqësoren amerikane përballë Milanit, ekip me të cilin ka arritur suksese të paharrueshme si lojtar dhe trajner. "Luftuam dhe bëmë gjëra të mira. Shumë të rinj zbritën në fushë. Rëndësi kishte të konkurronim, dhe ne e bëmë gjatë gjithë takimit. Vlerësimi është pozitiv. Për të rinjtë ishte një shans i madh për të luajtur në ndeshje të tilla. Në pjesën e parë bëmë me mirë me 'senatorë' si Modriq dhe Rudiger, por për momentin këta lojtarë nuk mund të luajnë më shumë se një pjesë. Le të përgatitemi për takimin e radhës", ka theksuar tekniku italian. Reali do ta sfidojë Barcelonën në një "El Clasico" amerikane më 4 gusht (01:00). Brazilianët Vinicius, Rodrygo dhe Militao janë gati të bashkohen me skuadrën, teksa pritet të luajnë disa minuta në



duelin përballë katalanasve të Hansi Flick. Ancelotti vijon duke theksuar se për momentin objektivi është arritja e formës së mirë fizike. Ndërkohë që po zhvillon një punë të madhe taktike me të rinjtë. "Duam ta arrijmë sa më shpejt formën fizike. Po punojmë taktikisht vetëm me të rinjtë. Kur të kthehen të gjithë lojtarët do të nisim ta bëjmë edhe

me pjesën tjetër të skuadrës. Në fakt, skuadra është pothuajse e njëjta me atë të sezonit të kaluar, kështu që strategjitë janë të qarta. Duhet të përshtatemi edhe me lojtarët e rinj, por pak nga pak, nuk duhet të nxitojmë. Mbappe-Endrick? Nevojitet kohë, nuk mund t'i përshtatim brenda pesë ditëve", ka përfunduar trajneri i Realit të Madridit.

SHKURT

Trajneri i Sivassporit: Refuzuam 7 milionë euro për Manajn

Trajneri i Sivassporit, Bylent Ujgun, ka thënë se janë refuzuar shumë oferta edhe të rëndësishme ekonomike për Rei Manajn, pasi janë cilësuar ende të ulëta për vlerat që ka lojtari shqiptar. "Ka 3-4 skuadra që e duan Manajn, por nëse nuk do t'i marrim parametrat financiarë që kërkojmë nga këto skuadra, drejtuesit tanë nuk do ta lejojnë të largohet. Manaj po bën stërvitje speciale këto ditë. Ai do të kthehet përsëri te Sivasspori. Ka 3-4 skuadra, por nuk janë në nivelin e kërkesave që kemi. Ne nuk shohim për shifra të tilla. Ata na kanë ofruar 6-7 milionë euro dhe nuk e kemi pranuar. Ai gjithsesi është një javë me leje, pas një jave do ta mbyllë stërvitjen individuale dhe do t'i bashkohet skuadrës", ka thënë trajneri i Sivassporit.

Tërhiqet nga gara favoritja për medaljen e artë në 100 metra

Kampionia e dyfishtë e botës në 200 metra, Shericka Jackson nga Xhamajka, nuk do të garojë në dy garat sprint në Lojërat Olimprike të Parisit pasi ka hequr dorë nga gara 100 metra për ta mbrojtur trupin e saj. 30-vjeçarja Jackson, e cila u dëmtua në garën e saj të fundit para Lojërave në Hungari më 9 korrik, regjistroi kohën më të mirë të sezonit të saj prej 10.84 sekondash për të fituar 100 metra në provat e Xhamajkës muajin e kaluar. "Është një kombinim gjërash", ka thënë Jackson në një aktivitet me median të mërkurë në Puma House. "U dëmtova në Hungari dhe është një vendim i mirë të garoj në një ngjarje të vetme. Mendoj se kjo është vetëm për ta mbrojtur trupin tim. Për tre vitet e fundit kam garuar në të dyja ngjarjet, dhe mendoj se ky (vendim) është një kombinim i të dyjave, thjesht duke u fokusuar në një ngjarje (ajo që ndodhi në Hungari)". Jackson gjithashtu fitoi medalje argjendi në kampionatet botërore të 2022-s dhe 2023-s dhe medalje bronzi në distancën më të shkurtër në Lojërat Olimprike të Tokios.

Olmo i gatshëm të transferohet në Barcelonë

Padyshim ishte një nga lojtarët kyç të Spanjës në "Euro 2024". Dani Olmo kërkohet nga ekipet gjigande të Evropës, por prioriteti i 25-vjeçarit duket Barcelona. Gazetari i njohur sportiv Fabrizioo Romano thotë se Olmo është i gatshëm të pranojë kushtet që i janë ofruar Barcelonës. Nga ana tjetër, bisedimet mes Leipzigut dhe katalanasve po kryhen për paketën financiare. Olmo ka një klauzolë largimi prej 60 milionë eurosh.

Matiq i dhuron Kroacisë medaljen e parë të artë në 'Paris 2024'

Barbara Matiq ka fituar medaljen e parë të artë të Kroacisë në Lojërat Olimprike 2024 në Paris. Xhudistja Matiq mundi gjermanen Miriam Butkerei në finalen e

70 kg për femra për të rrëmbyer kështu një medalje historike. Kjo ishte medalja e dytë e Kroacisë në Lojërat Olimprike pas asaj që mori Miran Mariçiç. Për 29-

vjeçaren nga Spliti, Matiq, kjo ishte një ditë mjaft pozitive, pasi së pari ajo mposhti Kim Polling të Italisë 10-0, përpara se të triumfojë ndaj Al Tsunoda

Roustant nga Spanja me të njëjtin rezultat. Matiq shkëlqeu në gjysmëfinale, duke likuiduar Sanne van Dijke nga Holanda 10-0. Xhudistja është dy herë

kampione e botës dhe në fillim të këtij viti ajo fitoi titullin evropian për herë të parë pasi fitoi katër herë medaljen e bronzit - 2014, 2017, 2019, 2023.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Learti Market” SH.P.K. me seli në Gjilan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812056605 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Learti Market” D.O.O. Gjilan, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812056605 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Learti Market” L.L.C. with headquarters Gjilan, has come to the decision to quit its business: 812056605 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “StatGIS” Sh.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 810539398 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “StatGIS” D.O.O. od Prishtina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810539398 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “StatGIS” L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 810539398 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT**SWISS****TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- P.P.“Hight Experience” shpall të humbur certifikatën e biznesit me nr Unik Identifikues: 811161489.

- Kol Keqa nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore “Remzi Pula” Doblibare.

- Firore Nuza Beluli nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit Birra Dukagjini me nr. 810069492

- Afrim Sylejmani nga Gjakova shpall të pavlefshme licencën e punës me nr. KO-00481-01-23. Të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër “Bill Clintonit”, kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra “Qerimi2”, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, "Swiss Kosova Power" L.L.C. Prishtinë në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për parkun e energjisë diellore "Gjakova Solar 1" - 9.98 MW në lokalitetin "Rracaj" ZK Rracaj komuna e Gjakovës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 18.09.2024 në ora 09:00 në sallën e Kuvendit Komunal në Gjakovë, do të organizohet debat publik nga Kompania "Swiss Kosova Power" L.L.C. Prishtinë në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/82757928911?pwd=TEW0bHuToVMJA8ARHJGpYa7BYrj3gC.1>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Swiss Kosova Power" L.L.C. Prishtinë për parkun e energjisë diellore "Gjakova Solar 1" - 9.98 MW në lokalitetin "Rracaj" ZK Rracaj komuna e Gjakovës.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, "Swiss Kosova Power" L.L.C. Prishtinë në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për parkun e energjisë diellore "Gjakova Solar 3" - 9.98 MW në lokalitetin "Rracaj" ZK Rracaj komuna e Gjakovës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 18.09.2024 në ora 10:00 në sallën e Kuvendit Komunal në Gjakovë, do të organizohet debat publik nga Kompania "Swiss Kosova Power" L.L.C. Prishtinë në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/82757928911?pwd=TEW0bHuToVMJA8ARHJGpYa7BYrj3gC.1>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Swiss Kosova Power" L.L.C. Prishtinë për parkun e energjisë diellore "Gjakova Solar 3" - 9.98 MW në lokalitetin "Rracaj" ZK Rracaj komuna e Gjakovës.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, "Swiss Kosova Power" L.L.C. Prishtinë në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për parkun e energjisë diellore "Gjakova Solar 2" - 9.98 MW në lokalitetin "Rracaj" ZK Rracaj komuna e Gjakovës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 18.09.2024 në ora 09:30 në sallën e Kuvendit Komunal në Gjakovë, do të organizohet debat publik nga Kompania "Swiss Kosova Power" L.L.C. Prishtinë në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/82757928911?pwd=TEW0bHuToVMJA8ARHJGpYa7BYrj3gC.1>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Swiss Kosova Power" L.L.C. Prishtinë për parkun e energjisë diellore "Gjakova Solar 2" - 9.98 MW në lokalitetin "Rracaj" ZK Rracaj komuna e Gjakovës.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, "Swiss Kosova Power" L.L.C. Prishtinë në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për parkun e energjisë diellore "Gjakova Solar 4" - 9.98 MW në lokalitetin "Rracaj" ZK Rracaj komuna e Gjakovës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 18.09.2024 në ora 10:30 në sallën e Kuvendit Komunal në Gjakovë, do të organizohet debat publik nga Kompania "Swiss Kosova Power" L.L.C. Prishtinë në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/82757928911?pwd=TEW0bHuToVMJA8ARHJGpYa7BYrj3gC.1>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Swiss Kosova Power" L.L.C. Prishtinë për parkun e energjisë diellore "Gjakova Solar 4" - 9.98 MW në lokalitetin "Rracaj" ZK Rracaj komuna e Gjakovës.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, "Swiss Kosova Power" L.L.C. Prishtinë në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për parkun e energjisë diellore "Gjakova Solar 5" - 9.98 MW në lokalitetin "Rracaj" ZK Rracaj komuna e Gjakovës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 18.09.2024 në ora 11:00 në sallën e Kuvendit Komunal në Gjakovë, do të organizohet debat publik nga Kompania "Swiss Kosova Power" L.L.C. Prishtinë në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/82757928911?pwd=TEW0bHuToVMJA8ARHJGpYa7BYrj3gC.1>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Swiss Kosova Power" L.L.C. Prishtinë për parkun e energjisë diellore "Gjakova Solar 5" - 9.98 MW në lokalitetin "Rracaj" ZK Rracaj komuna e Gjakovës.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, "Swiss Solar Park" L.L.C. Gjakovë në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për parkun e energjisë diellore 9.98 MW në lokalitetin "Madanaj-Ripaj, ZK. Kodra e Hutit" komuna e Gjakovës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 18.09.2024 në ora 08:30 në sallën e Kuvendit Komunal në Gjakovë, do të organizohet debat publik nga Kompania "Swiss Solar Park" L.L.C. Gjakovë në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/82757928911?pwd=TEW0bHuToVMJA8ARHJGpYa7BYrj3gC.1>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Swiss Solar Park" L.L.C. Gjakovë për parkun e energjisë diellore 9.98 MW në lokalitetin "Madanaj-Ripaj, ZK. Kodra e Hutit" komuna e Gjakovës.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, "Swiss Kosova Power" L.L.C. Prishtinë në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për parkun e energjisë diellore "Gjakova Solar 6" - 9.98 MW në lokalitetin "Ripaj", ZK. Kodra e Hutit" komuna e Gjakovës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 18.09.2024 në ora 11:30 në sallën e Kuvendit Komunal në Gjakovë, do të organizohet debat publik nga Kompania "Swiss Kosova Power" L.L.C. Prishtinë në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/82757928911?pwd=TEW0bHuToVMJA8ARHJGpYa7BYrj3gC.1>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Swiss Kosova Power" L.L.C. Prishtinë për parkun e energjisë diellore "Gjakova Solar 6" - 9.98 MW në lokalitetin "Ripaj", ZK. Kodra e Hutit" komuna e Gjakovës.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

Lumë's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lumë's Details
lumessedetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



TRADITË QË NGA

1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulo C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

